

BIBLIOTEKA
SHTETIT


814-1
M 17

KASTRIOT
MAHILAJ

VILJ
POEZI

81H-1


1917



KASTRIOT
MAHILAJ

VIJ

POEZI



13333

N. INV

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

Tirazhi 1500 kopje

Format 70x100/32

Stash: 2204-72

KOMBINATI POLIGRAFIK — Shtypshkronja e Re
Tiranë, 1977

V I J

Vij me ballin mbjellë lule djerse,
Bëmëni vend, poetë!
Për revolucionin unë zërin e ngre
gjer në qiell
Dhe e jap si këngën, jetën.

S'di të përdridhem si ngjalë,
Ndaj çdo gjëje mbaj qëndrim të prerë,
Armikun godas rreptas me varg,
Siç mund t'i bie dhe me predhë.

Hapmëni një vend në llogoren tuaj,
Ku buçasin orë e çast bataretë,
Vij i djersitur prej transheve,
Bëmëni vend, poetë!

M E T Y !

Sikur e shoh djepin tim, ja, atje në qoshe,
Ja, dridhet ninulla e nënës nëpër dhomë,
Që larg vjen zëri i saj i ngrohtë

kur më thoshte:

«M'u bëfsh për Parti, o biri im i njomë!»

Dhe pragun arrita.. u hodha më këmbë,
Mblodha lule në lëndinat e dashurisë sate
Dhe i hodha me vrap në të parën këngë
Dhe nëpër të gjitha këngët e ardhme...

Gdhenda emrin tënd në trung të aheve,
Shkrova dhe në dritë të yjve dhe të hënës:
Ngreh krahët dashuria prej të gjitha vargjeve,
Si krahë të malluar hedhur nënës.

Nderi im — llogorja, kudo që të gjendet,
Djersa e pastër rrjedhur në Jug a Veri.
Dhe hapi i fundit veç në udhën tënde
Do të kumbojë, Parti!

KUR VJEN 5 MAJI

Kur vjen 5 Maji,

Hap dita

Si balli i madh e i kuq i dëshmorëve.

E kuqja shpërthen nga toka përmes luleve,

Shpërthen nga ne përmes këngëve,

Sikur të kenë brenda plagët e të rënëve...

Kur vjen 5 Maji

Nënat e dëshmorëve ndiejnë peshën e bijve

Thellë trupit të tyre,

Dhe venë tek ata

Me ca lule të bukura në duar,

Me fjalët e dridhshme në buzë:

«Të keqen nëna!..»

MIKU IM, MINATORI HAXHI

Ka njëzet vjet që hahet me shkëmbinjtë
I miri, i urti, minatori Haxhi.
Si rremba guri i ka gishtërinjtë,
Shkëlqim mineral i shkrepet në sy.

Njëzet vjet ndaj shkëmbit ballë për ballë
Shkep mineral me pistoletë;
Rrudhat nga shkëmbi iu hodhën mbi ballë,
Sikur të qe një copë e shkëmbit vetë.

— Njatjeta, xha Haxhi, — them sa e shoh
Mesditave, mbrëmjeve a mëngjeseve në ag;
Sytë m'i shkëlqen:

— Njatjeta, djalo!
Dhe ikën e ballin me djersë e lag...

I thjeshtë çapitet ai,
Nga supet duart i varen të rënda.
Se ç'kam një joshje para duarve të tij,
Dua t'i prek dhe rri si mbi gjemba...

— Pa toke këtu, — më thotë, — djalo!
Dhe gazi i syve i shket mbi fytyrë...

Dhe qesh me gjithë shpirt i miri xha Haxhi,
Nga e qeshura gjoksi i hidhet përpjetë,
Nga e qeshura kokërr loti i bëhet në sy:
— More, ç'e paske këtë dorë të lehtë!

Hajde me mua të ngremë vagonë,
T'i shkepim shkëmbinjtë me mineral,
Ta thuash pa frikë, pastaj, se e tepëron:
M'u bë zemra mal!

Dhe dorën e rëndë ma rrëzon mbi supe,
Dhe kokën ma pështet mbi gjoksin-granit.
Unë ndiej fortësi shkëmbi në trup të më futet,
Dhe aromën e punës thellë në shpirt.

VJERSHË NGA TIRANA PËR FSHATIN TIM

U bënë vite që kam ikur
Nga malet e tua syri merr...
Ky malli yt seç më ka pikur
Mu thellë në shpirt, o Sevaster!

Aty mes malesh unë u linda,
Ku majë e Tartarit shndrit,
Aty u çora dhe bërtita,
Kur s'më kishte nëna më në gji...

Dhe djepin zbrita për të parë
Se ç'ish te pragu ajo dritë...
Dhe thura ëndrrën më të parë:
Mbi mal të ngjitesha një ditë!

U bënë vite që kam ikur,
Nga malet e tua syri merr...
Ky malli yt seç më ka pikur
Mu thellë në shpirt, o Sevaster!

Kam mall mbi bar të borroçitem
Me shokët kapur si gjërpej
Nga «shesh i burrit» të mos shqitem
«Sikur ta di që prapa s'kthenj»

Këmbët t'i ngjesh në bark të kalit
Dhe deleve t'u fishkëllej,
Kur ndonjë sosh këputet zallit ;
Të hidhem hop edhe ta kthej...

Dielli kur del, të jem në arë,
Të hyp, të ngas një pendë me qe
Dhe të derdh djersë me fshatarë,
Dhe të shoh gjurmët përmbi dhe...

Mbi male tjerë i zbardhin kreshtat,
I lartë është mali i fshatit tim.
Sikur më thotë prej kilometrash:
«Unë po të pres, o biri im!»

Ç'PATI GUSHËBARDHA, Ç'PATI

— *motiv popullor dasme* —

Ç'pati gushëbardha, ç'pati,
Që si gjeth i dridhet shtati?
Thonë pleqtë me të qeshur:
Nga që ndahet nga i ati.

Gushëbardha, erëmendra,
Ç'të kërcen te gjoksi brenda?
Thonë plakat me të qeshur:
Nga që ndahet nga e ëma.

Syr' i nuses, lot e dritë
Porsi dita diell e shi.
Dhëndër, dielli është yti,
Shiu, nënë, është për ty.

Ç'pati gushëbardha, ç'pati?
...Gusha hënë i jep fytyrës
Krushk mes krushqish bëhet gati
«Gazi» i kooperativës.

Nuse, dhëndër, ç'prisni më?
Pa i zini ato duar!
...Gushëbardha seç u bë
Gush' e faqe prushëruar.

VËSHTRIM NGA MALET

Zbresin pleqtë e fshatit nëpër muzgjë,
Pranë bustit të heroit ulen, rrinë.
Vijnë e i thonë: «Si u ngryse?»
Ikin e i thonë: «Natën e mirë!»

Ngrenë kokat thinjoshe nga heroi,
Ngrenë ballet e brazduar nga mendimet,
Dhe shkrepin një pas një urorin
Dhe ndezin një pas një kujtimet.

Ia marrin pastaj këngës ngadalë,
Përmbi këngë heroi rri i heshtur
Mjekrën pështetur mbi ison labe,
Sytë nga faqja e malit hedhur.

Mendimet pleksur i rrinë ballit,
Sytë lart i mban, mbushur mall.
...Ç'ia vështron ashtu, Perlat, shtigjet malit
Si atëherë kur ishe ilegal...

Ndaj bashkëfshatarët ta ngritën bustin
Pranë shtëpive të tyre, ballëmali.
...Vrapojnë fëmijët, lule këpusin,
Kush e kush të t'i sjellë i pari.

K Ë N G A

..Lutem, transmetoni për mua këngën e dëshmorit.. (Nga kërkesa e të birit)

Ah, më djeg kjo këngë
Ja, këtu te balli,
Sikur dora jote
Kur vije nga mali.

Thellë shpirtit tim
Zbret një mall i zjarrtë,
Ndërsa ti mes këngës
Vjen si në mes flakësh.

Dorën te naganti,
Supin te dyfeku
Gishtin përmbi këmbëz,
Këmbëzën te fisheku...

Ndaj këngën, baba,
Ta kërkoj unë, djali,
Të më zbreç nga kënga
Siç zbrisje nga mali.


Dhe të ndiej kaq pranë,
Të ngriti liria.
Gjaku ynë, baba,
Lidhet te Partia!

ZËRI YT, GJYSH

Varr i gjyshit tim nderet
Në një këmbë mali.
Dhjetë vjet që çdo pranverë
Mbin, i rritet bari.

Dhjetë vjet, eshtrat të qeta,
Tok me jataganë.
Gurët zbardhin (tundin mjekrat)
«Lamë bijtë tanë.»

Pas kaq vitesh më pru udha,
Shkund dy pika lotë...
Gur i varrit i mbledh rrudhat:
«Të dija të fortë!...»



13333

I fortë jam, si ti më deshe,
Gjyshi im i sertë;
Do tani të buzëqesh?
...Mall e asgjë tjetër...

E mban mend Koçiu,¹⁾ Kota,
O male me hënë,
Sokëllimën «përmbi ta!
Për gryke t'i zëmë!»

Erdh' Partia, mal u ngritët,
Pa bukë e pa ujë,
Bëtë detyrën e u shtritë
Një pas një pa bujë.

1) Qafë e Koçiut mbi Vlorë, ku u ndez e ashpër lufta me Italinë, më 1920.

GJYSHËRIT DHE DETI

Gjyshërit tanë të mirë detin
S'e panë kurrë nga rërë e vila,
Por nga brigje, majëmale,
Duke thirrur mbi rrëpira.

Dhe tek shihnin nëpër det
Armikun nëpër vaporë,
Ç'plaste zemra mbi dyfek,
Ç'digjte dyfeku në dorë...

Si të hidheshin mbi det,
Dallgët s'qenë tela me gjemba...
Varej copë gunë e shkretë,
Zbehej balli, hidhej zemra.

Hidhej zemra, doj të dalë,
Doj të hyrë te dyfeku,
Të arrinte pushkë e larë,
Ku nuk soste dot fisheku.

ME SYTË E BUKUR SHIHMËNI

Ju bëftë qumësht i bardhë, lopë,
Bari me vesë nga lugje mali mbledhur
Unë e dua erën tuaj të ngrohtë
Dhe s'i rrudh turinjtë nga kundërmim i plehut.

Pa shihmëni njëherë, duhet të më njihni,
Si mund të ndodhte, ju, të urtat t'ju harroja
Unë, që fëmijë, duart e ngrira nga thëllimi
Në sisët tuaja i ngrohja...

Unë jam ai vocërraku me arna të shpeshta,
Që hidhja në ditë me ju dhjetë përrenj,
Që ju s'më mërzitëshit kur nisja e shihesha
Në sytë tuaj të bukur, të mëdhenj...

E ç't'ju them për këto vite, lopë të dashura,
Pas dritareve të auditorit më shfaqeshit ju,
Pas më ndoqi ajo e dhembshura, e zgjatura:
Muuu...

Paçka se u largova nga fshati një copë herë,
Unë mallin për ju, lopë, s'e ftoha;
Për këtë u bëra dhe veteriner
Dhe nusen me sy mëshqerrë e zgjedha.

Ndaj shihmëni me sytë e bukur
Dhe faqen mbi qafën tuaj të ngrohtë
ma lini.
..Unë po ju kruaj nën brirë si dikur
Dhe ju, po deshët, më lëpini...

TROKET PRANVERA

Troket pranvera nëpër trungje
Me sqep lejleku, qukapiku,
Hollohet bora nëpër lugje,
Shkund kryet bari i stërpikur.

Veç majë e malit po shkëlqen,
Dëbora brigjesh krejt u var
Në shtrat rrëkerash dhe përrenj
Të bardhë mben' veç lapidarët...

Troket pranvera, dal në fushë
Ku beli krahun zbukuron.
Kjo avër e brazdës nëpër gushë
Më mpikset musht e më ngacmon...

Një lulëshqerrë, një lulëkuqe
Si sy të qeshur përmbi dhe,
Kur ja: hap buzkat një burbuqe:
— Pranverën nënë kemi ne!

Troket pranvera për nën dhe
Jam unë — zgjat kokën gruri i bukur,
Jam unë — thotë bimëza e re —
Më bëni vend se ju kam bujtur!

Dhe ti e shqerrta, moj fshatarkë,
Mos shko, më qafsh, me aq serbes,
E çë s'e bëra shkollë të lartë,
Ti nusja ime do të jesh.

Ehu, sa tokë ne do mbjellim,
Do korrin, shijmë, do hedhim farë...
Prandaj prit dasmën një të dielë,
Ashtu më rruash, moj gushëbardhë.

Troket pranvera në damarë,
Në gjoks ku zemra si zog rreh,
Si zog që viset do të marrë
Me cicërimë përmbi atdhe.

U R R I T Ë M

Shpërtheu rinia jonë, shpërtheu,
O brezi im ballëbardhë!
I bukuri
Si vezullim i pushkës mbi sup të atdheut,
I thjeshti
Si fisheku i gjerdanit në radhë...

Freskia jonë, atdhe,
Ta ripërtërin pranverën,
Frymëmarrja jonë t'i zgjeron mushkëritë,
Gjaku ynë i vluar ta ngroh zemrën,
Buzëgazi ynë t'i qesh sytë.

U rritëm
Dhe në ballin e Shqipërisë u shtua një rrudhë,
U shtua në flokët e saj dhe një thinjë e bardhë...

Përkëdhel ajo tani një melodi të re në buzë
Dhe thotë
«Më rrofshi, bij, që m'u bëtë të mbarë!»

Domosdo, Shqipëri, që do të të bëheshim të mbarë,
Se si mund ta harronim bukën që na bëje në magje?
Të vegjël,
Me duart e vockla të fshinim djersën e valë,
Sot burra,
Me djersën tonë ta zbardhim faqen...

BUZËQESHJE E DETARËVE

Afrohemi në breg
Dhe nëpër të gjithë trupin
Na ngroh gjithnjë e më shumë malli për tokën.

Nga gjiri i tokës
Një kep për zgjatet.
...Nëna ka shtrirë duart, pret te pragu.

Buzëqeshim
Dhe nga vijëzat e fytyrës
Shkërmoqet e bie kripa e zbardhur.

Kështu do të buzëqeshim gjithmonë!

Edhe sikur
Nëpër vijëzat e fytyrës të na buisë gjaku.

NË SHËRBIM NJË NATË FESTE

Këtë natë po derdhet kaq shumë gëzim,
Këtë natë po thuhet kaq shumë urime.
Njerëzit ndajnë lumturinë bashkë,
Unë jam i vetëm me pushkën time.

Sot e tërë qenia ime është një copë
vigjilencé.
Buzë detit eci me hapin tim të qetë.
Nëpër dhoma rreze të bardha thyhen
në qelqe,
Mua hëna mbi sup më shtrihet në bajonetë.

THINJAT E PARA

Na dolën të parat thinja,
I keni vënë re, moshatarë?
..Sot flokët tek bëra t'i krihja,
Ato rrezëllyen si ar.

M'u derdh në shpirt një mall i vakët
Dhe zgjata dorën, bëra t'i çikë:
Mes flokëve të zez si nëpër natë
Ato u drodhën me frikë...

O thinja të bardha të shqetësimeve të bardha,
Pse po më druheni, pse keni frikë?
Flakeni turpin, dilmëni të parat,
Ndër flokët e zez ju kam si mike.

Nga më erdhët kështu, papritur,
Në moshën njëzetvjeçare?
Të jemi mes nesh të çiltër,
S'ju prisja fare...

KUR RANË

Dhe u rrëzuan butë mbi tokën mëmë.
Dhe e shtrënguan për lamtumirën e fundit
Te një tufë bari,
te një copë guri,
te një grusht dheu...

Nga dejet e prerë delte me shpejtësi jeta
Dhe hynte me vërshim në çast atdheu.

ZEMRA ËSHTË PARTIA

baladë

Kodrat ngjiten malit,
Mali me gjëmime.
Partizanët varg,
Rënë në mendime.

Ç'ka përmbi dëborë,
Ç'u rëndon mbi supe?
Kthejnë kokën prapa,
Ca pika të kuqe...

Plagë e komisarit
Pikon gjak të ngrohtë,
Ngjitem — thotë ai,
Ngjitem — gjaku thotë.

— Duro, — thonë supet, —
Ja, do ndezim zjarrin...
Ngjitet e nuk lodhet
Gjak i komisarit...

2.

Çau çeta, çau,
Në rrethim e pritë;
Plagë e komisarit
Ç'po dhemb te të gjithë!

Pikon plagë e kuqe,
Dridhet, mblidhet toka.
Zjarri partizan
I digjet te koka.

Komandanti, zbehur,
Me dhëmbë i pret ofshet:
«Do vijnë, komisar,
Ditët që na thoshje!».

Ka zjarr komisari,
O ç'po do të ngrihet!
Dëbora mbi ballë
Përgjaket e shkrihet...

Ja, ngrihet së paku
I shikon me radhë,
Ylli me rrënjë gjaku
Rritet përmbi ballë.

Buz' e tija shkrumb
Zjarr i jep çdo fjale.
U ngjajnë partizanëve
Si gjuhëza flake:

«Vdekja po më ndan
Shokë... vjen liria...
Jam një pikë gjaku,
Zemra është Partia...

Jam ushtar i saj,
S'ju shoh përmes lotëve...»
Balli iu rrëzua
Në duar të shokëve!

Folna, komisar,
Ngrihi ato duar...
Pëllëmbët fort yllin
Mbajnë të shtrënguar.

Flakë e idealit
Që i digjej syve,
U fut përmes zjarrit,
Flakëroi flamujve.

Shkroi poeti i çetës,
U drodh violia:
«Jam një pikë gjaku,
Zemra është Partia...»

3.

Kodrat zbresin malet,
Zbret me vrap liria;
Çeta këndon këngën:
«Zemra është Partia...»

Q Ë N D R E S Ë

Ndoshta nga dhimbja
e tokës mëmë
U tkurrën vargmalet tona,
U holluan, u çanë...

Ndoshta për nderin
e tokës mëmë
S'i ulën majëthikat,
S'i dhanë.

Ndoshta për ëndrrën
e tokës mëmë
Duart shkëmbore varg
Lidhën besa-besë.

Mbi këtë tokë historia
Me kurrizet e vargmaleve
Ka shkruar fjalën QËNDRESEË.

BARI I TOKËS SONË

Zvaritemi me bërrylet ndër plisa të futura,
Na këputen nga ballët rruzuj djerse,
Shkunden fijet e barit të përgjumura:
«Po ç'është tani, kjo vesë?..

Zvaritemi me bajonetën përpara nxjerrë.
Fijet e barit nëpër vesh na pëshpërisin.
— O bar i tokës sonë,
Jo vetëm me djersë,
Por dhe me gjak,

po qe se duhet
të vadisim! —

DËSHMORËT

Vijnë me dorën të shtrënguar,
Plumbi ku i mori...
Plot me erë, tufan lirie
Mbushur krahërori.

Vijnë... na çelin horizontet
Me plagët e kuqe.
Dritë ylli, tym baroti,
Dridhur përmbi supe.

Zbresin nëpër udhë mali,
Shprazia krisma lufte.
Toka mëmë zhuritur malli
Shpërthen lulëkuqe...

Ne u puthim pushkënxehtën
Dhe yllin në ballë
Mallin për ta shkëmbëzojmë
Nëpër lapidarë.

Ja, kështu, përherë do vijnë
Të mirët dëshmorë,
Një pas një si palë flamuri,
Hapur lart mbi dorë.

Supin kam vënë nën peshën e shtrenjtë,
Ecin kujtimet me mua ngadalë,
Si atëherë më ka hedhur dorën e rëndë:
«T'i shkepim shkëmbinjtë me mineral,

Ta shtrijmë ballin e shkëmbit përdhe,
Të bardhë faqen t'ia kemi Partisë...»
Krahu më mpihet,
unë mbaj mbi supe
Heroin tim të poezisë.

Ja kështu, si ti, ikshim, Haxhi,
Mbi supe shokësh, mbi çape të rënda.
...Kumbojnë hapat në galeri,
Me dorën me kallo mbahesh te kënga!

FANJO, MOJ BIJËZ

Dëshmoret 15 vjeçare Fanjo Çiçaku

Fanjo, moj bijëz,
Me 15 pranvera.
Po të thërras ç'prej vitesh,
Eja!
Eja, duke i prerë shtëllungat e barotit,
Si dallëndyshe,
Me mallin tonë të ngrohtë ndën pendë
E krahët m'i çlodh nga udha të lodhura
E më cicëro nën strehëz të këngës...

Gjaku yt i kuq
Pikë-pikë
Gjer në Mal të Zi.
Nën ç'plis e nën ç'gur
Ta mbledh me shami.

Ta mbledh me shami,
Ta hedh në flamur,
Fanjo, moj e njoma,
Me zemër prej burri.

Fanjo, moj bijëz,
Moj dallëndyshe e vogël,
Të janë djegur krahët?
Udhën dot s'e gjen?
Ver në vend të krahëve dy flatra prej flake
Dhe pas ëndrrës sate
Fluturo si era!
Fanjo, moj bijëz,
Me 15 pranvera..

LETËR ÇOBANËVE

Mbase do të zbresë ndonjë nga ju në fshat,
Mbase ngjitet postieri gjer aty, në mal.
Jam unë, që po ju shkruaj, më i riu çoban,
Tani marinar.

Ka mbajtur bar i mirë sivjet
E ma merr mendja, të gjitha i keni pëlleje.
Eh, dalim këtë stinë shpesh në det,
Shkumët e dallgëve më ngjajnë dele...

Dhe më duket se ruaj një det me dele,
Por ato ikin e s'lenë gjurmë..
E ndodh që ndonjë shok s'i heq sytë
prej meje,
Kur ua bëj me dorë deleve-shkumë.

S'gaboi syri i çobanit edhe këtë herë,
Vetë komandanti më tha — qenke burrë!
I tregova atëherë, si me pushkë ato net
Përgjonim kur afrohej ujku i murrmë.

Kur mitralozin si kërrabë e hedh në krahë,
Më sheh komandanti dhe buzëqesh;
— S'më ke parë, i them, s'më ke parë
Me 3-4 qingja për qafe e supesh.

Mbase do të zbresë ndonjë nga ju në fshat,
Mbase ngjitet postieri gjer aty, në mal;
..Bien këmborët tani shpat më shpat,
Dërgomëni dy bashka leshi të bardhë, çobanë!

SI MAL I BARDHË I FSHATIT TIM...

Në krah të shokëve me besë
Ngre ballët mal i fshatit tim.
Për hasmin shpata ç'i ka presë,
Ç'i ka baroti shkrepëtimë.

Nuk bie në sy, se çfarë, në hartë,
As dy mijë metra s'i arrin,
Por me fshatarët e mi mbi shpate,
Me dhjetëra mijë ngre trimërinë.

Ka pleq që pleqërinë s'e qasin,
Ka burra, gra, me fjalë, me thinjë,
Ka djem e vajza që më ngjasin
Si vesë pikuar mbi kallinj.

Se ka një majë,
po ka një besë,
Q'e mban të pastër mbi dëborë:
Në rrugën e Partisë të ecë
Me shokët varg, dorë për dorë.

Se pse kam qejf ta them një vjershë —
Lartoj me vitet një qëllim:
Të jem trimosh edhe i thjeshtë
Si mal i bardhë i fshatit tim...

N Ë N Ë S S I M E

Unë sytë e tu të parët pashë në botë
Dhe ballin tënd të bukur me merak.
Nga ti e mësova, qysh në djep të ngrohtë,
Kush ishte Shqipëria, pak nga pak...

Dhe tundej djepi im gjithnjë e më vështirë,
Nën të, nga pesha ime, luante hatulla.
Ç'gëzim! S'dij ç'bënte nëna ime e mirë,
M'i fuste duart e saj nën shpatulla...

Më thua, nëna ime, tani që jam burrë,
Kur më këndoje mbi djepin e lashtë,
Lëvrija në rroba,
përpiqja buzët,

Dhe duart e vockla t'i ngrija lart.

U rritën duart, u bënë të rënda,
Të ashpra e të sërta si faqe stralli,
Por sot, mbi rrudha, ç'ma paska ënda,
Të t'i shkojë si atëherë, i ngrohtë nga malli...

NË LLOGARA NJË DITË GUSHTI

Këtu e paske qiellin mik të afërt fare...
..Me postën e linjës vij për herë të parë,
Tang-tung qëllon kjo koka në dritare,
Se pse më ngjajnë pishat më shqiptare...

Po ç'do në mes të rrugës kjo vijë e hollë kroi,
— Pa dilni, — thotë shoferi, gjoja seriozisht.
Ne dalim,
Një erë fryn nga mali,.. ç'na shëroi!
Na futet nëpër mëngë miqësisht.

Po kjo frushullimë kështu?
Fuu,
Fuuu...
Pishat rrahin e shkundin dëgët gjerë e
gjatë,
Si krahë shpendësh gjigantë,
Sikur bëjnë të ngrihen lart, lart...

Mbi kryet tona rrënjë pishash varen,
Ne udhën prapë në ngjitje kemi marrë.
Tang-tung qëllon kjo koka në dritare,
Mua pishat më ngjajnë më shqiptare.

«Që the ti djalë, të japë ky dhe
(Oha, Murro, ec drejt!)
S'mjafton të hidhet fara dhe,
Të bëhet bereqet.»

Mua, poetit, sikur më tha:
«Po s'ndenje fort te vija,
Po s'ndoqe vargun pas,
aha,
S'të bëhet poezia.»

PALLATI I RI I DIMRIT

Kremlini mbi muret e vjetra
Ngre drapër-çekanin, kryq!
Strofull e bishave me kthetra,
Salloni i njerëzve të liq!

Pallat i Dimrit, Kremlini,
I të ftohtit të botës qendër.
E tërë Siberia e ngrirë
Brenda mureve të tij është mbledhur.

Nga portat fishkëllijnë nëpër borë
Nëpërkat e erërave dimërore
Me ngërç e ngricë nëpër botë,
Sot globi ka tri pole!

Mbi kullë Kremlin s'ka yll,
Ka vetëm një pesëcepësh kristal.
Nga akulli i Pallatit të Dimrit —
I tëri një copë kristal!

Nëpër yllin e tij të brejtur
Zgjat gjuhën gjarpri bullar,
Fishkëllin mbi kokat e njerëzve,
Mbi varret e bolshevikëve të vrrarë.

Tetori i hedhur në prangë,
I shtrirë muzeve si plaçkë.
Psherëtin nëpër grykën e gjatë
Aurora e zënë në grackë.

Por grykës së saj, komandë,
Sërish do t'i japë Lenini!
Dhe ujëra do të rrjedhë nën flakë
Akulli i Pallatit të Dimrit...

NJË GRUSHT VALËZASH NGA TI, DET...

poemë

1.

Vështrojnë malet nën thinja dëbore,
Valë pas vale deti diç më thotë...
Do më marrë malli për ty, llogore,
Do më marrë malli për ju, o shokë!
Do më marrë malli për pushkën time,
Për perëndimet kur dielli përflak,
Për detin e trazuar suferinë,
Për hapat e kumbuara nëpër natë.

Të presësh masën e dallgës me gjoks
Në post ku era qëllon me kamxhik,
Ku shkëlma detare të rreh si me grusht
Dhe ballin e faqet t'i fshik,
Kjo do të thotë se s'je hiç i dobët

Që ngasjen e mbake me zor,
Se s'ka të përbashkët asgjë me lotët
Ky malli yt madhështor...

Do më marrë malli për udhët e kaltërta,
Ku copëza të gëzuara dallgësh hidhen përpjetë,
Për malet

që si eter,

tej, brigjeve të largëta,

Kokat nga ne u mbetën;
Për valëzat, për dallgët kur thyhen nën kreshtë,
Për muzgjet dhe mëngjeset e hirta,
Kur eca çapëlehtë i frymëzuar për një vjershë,
Kur hapat alarmeve trokita...

2.

Vrapon nëpër shoqet përpara të më dalë
Ajo dita ushtare e parë.
Përhidhet mbi dallgë,

përzgjatet mbi valë,

Më thotë, kur vjen:

— S'më ke parë?

— Të njoh, — i them unë me pamjen e shtirur, —

Nga pushka s'kish zot të të ndante.

I ngre pak kapelen:

— Pa rri e gatitur!

E marr dhe e bëj komandante...

Kaq duan dhe thirrjet, brohoritjet nisin

Një mijë e ca ditë ushtarë,

Nën yll të gjithave sytë u ndrisin

Dhe kapen përdore në valle...

3.

Pret «Zis-i» në xhadenë që humb në zabele

Të marrim udhën e largët.

O ditë ushtarë me yje në kapele,

Trimëreshat e mia me uniformë të kaltër!

Jua ndiej të parat hapat e ndrojtura kaq pranë,

Ja ku ju kam supengjeshura në radhë:

Të gjitha

me djersë në ballë,

Të gjitha

me yje në ballë!

Ditë marshimesh detare të gjata,

Kur detin shkumbonim kryq e tërthorë,

Ditë-lule petalekaltra,

Rinisë sime m'i rrini kurorë.

Me ju pas shpine me ballët që ju ndrisin
 Do ngjit pa frikë çdo të përpjetë,
 Front më front të socializmit
 I pasprapsur në jetë!

4.

Tani sytë dritëbukur ngre nga ti, atdhe,
 Ngre ballin erërrahur ndezur purpur;
 Ti zgjat lehtë dorën e dhemshur edhe
 Më përkëdhel fytyrën e skuqur...
 Unë ndiej si nëpër 'të më shkasin bula djerse
 Siç shket vesa,
 e kuqe,
 mbi trëndafil.

Shqipëri... unë gjakun tim ta fal me buzëqeshje,
 Se jam një qelizë e jotja,
 një bir.
 Se jam bir i partizanit që skuqi dëborën
 Dhe këngën nuk e reshti prej urisë,
 Kur dorën ia qëlluan, s'e uli dorën,
 Që mbante flamurin e Partisë,
 Se është kaq i shtrenjtë çdo plis i këtij dheu,
 Mbi të s'ka shqotë e stuhi të më tundë!

Unë jam një notë e këngës së pafund
në buzë të atdheut,
Jam një fishek në gjerdanin e tij të pafund!

5.

Dhe s'do të thotë se u bëra i vrazhdë
Tani që balli i lëmuar m'u brazdua me rrudha.
Eh, të m'i shihnit dot sytë

kur ndiqja nën vazhdë.

Si përparonte me shpejtësi silura...

Të më ishit dot pranë, kur me kufje në vesh,
Vërvitja sinjale me tasto në hapësirë
Dhe gjeja shokun tim

sipër a poshtë resh

Diku në qiellin tonë, nëpër efir...

Detit me mua t'i binit pash më pash,

Ku ujët me zhurmë të futej në kiç,

Ku dallgë e harbuar të rrihte si dash

Dhe valën ta merrnim pas si oqiç...

Të ndienit dot si zemra rrihte,

Kur fluturonim me bashin e ngritur

përmbi dallgë,

Kur shkumën e argjendte

shatërvan hidhte

Katëri ynë si shpend me krahë të bardhë...

6.

Unë të vështroja, det, dallgët kreshtëbardha
E ti më pëshpërisje në breg së lehti,
Ku faqen kaltëroshe palos vala,
Ku muza e poezisë më gjeti...
Nuk doli ajo nga shkuma e valëve
Me mesin përdredhur me dhele,
Ajo erdhi si një vajzë e zakonshme ushtare,
Me yll të kuq në kapele.
Me dorën e shkathët më preku në sup:
– Të jemi të qartë, o shok,
Po s'ece në dritën e yllit, më humb,
Dhe s'ke për të më gjetur dot.
Unë dorën ia mora, ia rroka me besë:
– Me ty do të jem prorë!
Ajo më qeshej me syrin e blertë
Dhe ecëm të dy për dore.

7.

Dhe ta fituam, det, miqësinë e rreptë,
Udhëve ku gërvishëm cipën tënde,
Ti, të na përqafoje,
hidhje dallgë përpjetë,
Pas qitjes kur ia merrnim asaj kënge.
Me dallgë na kalite,
na përkëdhele me valë,

Anija — katëri im...

Me bashin trimosh të ngritur përperjetë,
Me krahë të bardhë me shkumë,
Në ditë dhe net me kohë të qetë,
Në ditë dhe net me shkumë,
Do turret me vrapin e kaltër përtej,
Një pikë do duket, do humbë,
Do shfaqet sérish, që mua të më gjejë
Si jele shkumën do të shkundë.
Dhe unë do të kap mes buçimës një zë,
Një zë që gjithnjë do më grishë:
— Te bashi i frontit të ngrihesh gjithnjë,
Frikaçi tulatet në qiç!

10.

Dhe buzët, vetiu, më thonë: Mirupafshim! —
Tani që «Zisi» e ndezi motorin
Dhe gusha dhe faqet m'u skuqën nga afshi,
Dhe zemra troket e trand krahërorin..
O shokë, llogore, o det i mirë,
Me zemër dhe gojë: — Mirupafshim!

11.

Pret «Zisi» në xhaden që humb në zabele,
Të marrim rrugën e largët.
E tillë është jeta jonë,
gjithnjë një betejë.

Nga armët tek kazma,
nga kazma tek armët!
S'është ndarje kjo me lotë sentimentale,
Por... seç më djeg këtu, në gushë,
M'u dashka të t'i vë buzët, o flamur mbi palë,
M'u dashka të ta puth tytën, o pushkë!...

Do marr kreshtëthinjurën dallgë me vete
Dhe vështrimin atëror të malit të lartë,
Ca gulshe erëdeti,
ca valë rebele,
Ca hapa, të trokitura nëpër natë.

Do marr të radios sime këngën bilbilore,
Do marr, o shokë, puthjen tuaj të nxehtë,
Do marr një grusht dhe
nga ti, llogore,
Një grusht krela valëzash nga ti, o det...

PASQYRA E LËNDËS

	Faqe
Vij	3
Me ty!	4
Kur vjen 5 Maji	6
Miku im, minatori Haxhi	7
Vjershë nga Tirana për fshatin tim	9
Ç'pati gushëbardha, ç'pati	11
Vështrim nga malet	13
Kënga	15
Zëri yt, gjysh	17
Gjyshërit dhe deti	19
Me sytë e bukur shihmëni	21
Troket pranvera	23
U rritëm	25
Buzëqeshje e detarëve	27
Në shërbim një natë feste	28
Thinjat e para	29
Kur ranë	30
Zemra është Partia	31
Qëndresë	35
Bari i tokës sonë	36
Dëshmorët	37

Një valle popullore në buzë të detit	38
Varrimi i minatorit Haxhi	39
Fanjo, moj bijëz	41
Letër çobanëve	43
Si mal i bardhë i fshatit tim	45
Nënës sime	47
Imazhi i duajve	48
Në Llogara, një ditë gushti	49
Mësim nga ara në brinjë	50
Pallati i Ri i Dimrit	52
Një grusht valëzash nga ti, det.. (poemë)	54